



Konferenca e V-të e përbashkët EUROSAT-ARABOSAI

Roli i SAI-ve në mbikëqyrjen e planifikimeve qeveritare për dhënien e asistencave
financiare për ekonomitë në krizë

7-9 dhjetor 2015

Deklarata e Dohas

Përgjatë tre ditëve delegatët e 35 SAI-ve pjesëmarrëse diskutuan rolin e SAI-ve në Mbikqyrjen e Planeve qeveritare në dhënien e asistencave financiare për ekonomitë në krizë dhe rolin e SAI-ve në paralajmërimin kundër risqeve të krizave të ardhshme financiare, duke u mbështetur në eksperiencat e tyre në vijim të krizës globale financiare që filloi në vitin 2007.

Pjesëmarrësit,

Duke qenë të vetëdijshëm mbi impaktin e fortë që krizat e tregjeve financiare kanë në ekonomitë e vendeve dhe jetën e interesat e qytetarëve, ashtu si edhe efektet dhe pasojat jo të favorshme në të gjitha nivelet,

Në lidhje me mangësitë e theksuara të dala në pah nga kriza në qeverisje dhe shqyrtimi i sistemit global financiar,

Duke njohur rolin që SAI-t luajnë në ruajtjen e ekonomive të tyre dhe sigurimin e qëndrueshmërisë financiare dhe zhvillimit të qëndrueshëm,

Duke patur parasysh Qëllimin për Zhvillimin e Qëndrueshëm nr. 16 dhe rolin e rëndësishëm që u është dhënë SAI-ve lidhur me ngritjen e institucioneve efektive, të përgjegjshme dhe gjithëpërfshirëse, në të gjitha nivelet,

Duke ditur se krizat financiare dhe masat e marra ndaj tyre sjellin sfida të reja për auditimin dhe përgjegjshmërinë, si në nivel kombëtar ashtu edhe në nivel ndërkombëtar,

Duke ditur dhe vlerësuar aktivitetet dhe përpjekjet e ndërmarra në këtë fushë nga komunitete të ndryshme të SAI-ve, si në nivel rajonal ashtu edhe në nivel ndërkombëtar, ashtu si edhe nga inisiativa e INTOSAI-t për të ngritur Grupin e Punës mbi Modernizimin Financiar dhe Reformën Rregullatore,

Mbështesin ARABOSAI-n dhe EUROSAT-n dhe SAI-t anëtare të tyre të:

1. Punojnë për të patur një rol aktiv në monitorimin dhe mbikqyrjen e veprimtarisë kundër krizave të ardhshme financiare dhe ngritjes dhe zbatimit të planeve qeveritare për dhënien e asistencave financiare për ekonomitë në krizë dhe të masave të tjera të marra në rastet kur ndodhin të tilla kriza.

2. Rrisin kontrollin në fushën e menaxhimit të borxhit publik bazuar në standartet INTOSAI dhe praktikatat e mira dhe të promovojnë transparencën e plotë të borxhit publik dhe detyrimeve (të mundshme) si dhe përshtatjen e praktikave më të mira në menaxhimin e riskut.
3. Forcojnë bashkëpunimin ndërmjet SAI-ve në mënyrë që të shkëmbehen eksperiencat, njohuritë dhe informacioni lidhur me verifikimin e rregullshmërisë dhe përputhshmërisë së masave ndaj krizave financiare dhe menaxhimit të riskut, ashtu si edhe partneritetit me Parlamentet për zbatimin e rekomandimeve të auditimit.
4. Kthejnë vëmendjen ndaj çështjeve të qeverisjes lidhur me institucionet financiare dhe ligjshmërinë e kuadrit rregullator të zhvilluar dhe miratuar, duke u fokusuar në transparencën dhe përshtatshmërinë e të gjitha rregullimeve mbi auditimin dhe përgjegjshmërinë (për shembull, nëse ka hapësira (gap) lidhur me auditimin në mandatet e tyre).
5. Mbështesin përcaktimin e mekanizmave paralajmërues kundër krizave financiare për të identifikuar risqet financiare si në nivel kombëtar ashtu edhe në nivel ndërkombëtar duke përdorur studime si ato të kryera nga institucionet ndërkombëtare ekonomike dhe organizata të tilla si, Fondi Monetar Ndërkombëtar dhe Bordi për Stabilitet Financiar, në vijim të raporteve dhe studimeve të zhvilluara nga Grupi i Punës i INTOSAI-t për Modernizimin Financiar dhe Reformën Rregullatore.
6. Nxisin subjektet e audituara të forcojnë kontrollet e tyre të brendshme dhe të përcaktojnë kuadrin menaxherial mbi treguesit e bazuar në risk sa herë të jetë e nevojshme.
7. Vazhdojnë të përmirësojnë aftësitë organizative dhe profesionale të SAI-ve duke përshtatur dhe zbatuar standartet e INTOSAI-t dhe praktikatat e mira në mbikqyrjen e vlerësimit të performancës financiare dhe përmirësimit të qeverisjes, ashtu si edhe të përdorimit të ekspertizës së huaj të specializuar kur kërkohet.
8. Kërkojnë nga INTOSAI të reflektojë nëse ka nevojë për zhvillimin e standarteve dhe zbatimin e udhëzuesve në këtë fushë.

Kërkojnë nga Presidentët e Sekretariateve të Përgjithshme të EUROSAT-t dhe ARABOSAT-t të përcjellin këtë Deklaratë tek Presidenti dhe Sekretari i Përgjithshëm i INTOSAI-t, ashtu si edhe tek Presidentët dhe Sekretariatet e Përgjithshme të Grupeve të Punës të Rajoneve të INTOSAI-t.